



01 Nr. 469/25 Dt. 29.07.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 lidhur me nenin 18 paragrafi 1.9 i Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 93205 datë 22.07.2025 të Eda Vllaço, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 93205 datë 22.07.2025 të Eda Vllaço, pianiste nga Prizreni, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth pjesëmarrjes në Festivalin Muzikor “Concerte Del Tempietto”, që do të mbahet me datën 16.08.2025 në Romë të Italisë, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshme të shpenzimeve (akomodim, bileta, etj.), lejohen mjetet financiare në shumën prej 800 € (tetëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurës,
- Arkivës së Kryetarit.

